

SHPALLJE PËR REKRUTIM EKSPERTI TË JASHTËM

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve(AIDA) bazuar në Ligjin Nr.10 303, datë 15.7.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA, kërkon të rekrutojë 1 (një) ekspert të jashtëm të kualifikuar në fushën e tregtisë elektronike(e-commerce), për zhvillimin e një webinarit me temë “*Tregtia elektronike/e-commerce si një mundësi inovative online për zhvillimin e bizneseve*”.

TERMAT E REFERENCËS

Objektivi

Mbajtja e këtij webinarit do të ndihmojë në përdorimin e e-commerce si një platformë inovative që ndihmon bizneset të jenë më konkurruese, si dhe të përmirësojnë procesin e të bërit biznes në treg. Gjithashtu, synohet që të arrihet informimi për sipërmarrësit në Shqipëri mbi tregëtinë elektronike, si dhe rrugën e prezantimit dhe forcimin e saj si pjesë e rëndësishme e strategjisë së rritjes së biznesit.

Kohëzgjatja maksimale e webinarit do të jetë 2 orë.

Detyrat Eksperti

Eksperti ka për detyrë të:

- Përgatisë një material mbi tematikën e webinarit. Materiali duhet të përmbajë pikat e diskutimit dhe një prezantim në Power Point.

-Gjatë webinarit të trajtojë edhe pyetjet që do ti bëhen nga pjesëmarrësit.

Data e zhvillimit të webinarit

Data e zhvillimit të webinarit është 9 Mars 2021, ora 15:00.

Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm

1. Të ketë diplomë master në fushën e Informatikës. Kualifikime të tjera në këtë fushë përbëjnë avantazh;
2. Të ketë minimalisht 5 vite eksperiencë pune në fushën e tregtisë elektronike;
3. Të jetë sipërmarrës me bazë shërbimet e tregtisë elektronike, si dhe të jetë aktiv në botën e teknologjisë së bizneseve;
4. Të ketë eksperiencë në analizë, dizajn dhe ndërtim faqesh për biznese;
5. Të jetë shtetas/e shqiptar.

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me standartet e legjislacionit shqiptar;
2. Fotokopje të diplomës master të noterizuar. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe e Sportit;
3. Fotokopje të dokumentacionit që vërteton eksperiencën në fushën përkatëse;
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID)/ Pasaportë

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

1. Dokumentacioni 60 pikë;
2. Intervista 40 pikë.

Kandidatët që përmbushin kriteret e lartpërmendura duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës **05 Mars 2021** në adresën e emailit info@aida.gov.al.